


# PRIORITETET E QYTARËVE TË PRIZRENIT 2020



Komuna e Prizrenit kishte organizuar dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit komunal për vitin 2020 gjatë muajit gusht 2019. Për të analizuar prioritetet e qytetarëve për investimet komunale për 2020, kuadër të projektit “OSHC-të lokale dhe qytetarët e fuqizuar në parandalimin e korrupsionit në prokurimet publike komunale”, të mbështetur nga aktiviteti i USAID për komuna transparente, efektive dhe llogaridhënese, ISDY ka monitoruar pesë dëgjime publike të organizuara nga Komuna e Prizrenit në procesin e hartimit të buxhetit komunal për vitin 2020.

Në këto pesë dëgjime publike, qytetarët kanë parashtruar **44 prioritete**, në **9 fushë veprimtari** të ndryshme, të paraqitura në diagramin më sipër.

Nga 44 prioritetet e parashtruara nga qytetarët, 23 (52%) e tyre ishin përfshirë në buxhetin e komunës për vitin 2020.

## Dëgjimet e monitoruara ishin:



Dëgjimi i mbajtur në **Gjonaj** me datën **19 gusht 2019**, ku kanë marr pjesë

**54 qytetarë**



Dëgjimi i mbajtur në **Zhur** me datën **20 gusht 2019**, ku kanë marr pjesë

**62 qytetarë**



Dëgjimi i mbajtur në **Reqan** me datën **21 gusht 2019**, ku kanë marr pjesë

**22 qytetarë**



Dëgjimi i mbajtur në **Korishë** me datën **22 gusht 2019**, ku kanë marr pjesë

**17 qytetarë**



Dëgjimi i mbajtur në **Shtëpinë e Bardhë në Prizren** me datën **23 gusht 2019**, ku kanë marr pjesë

**50 qytetarë**

Tabela në vijim pasqyron kërkesat sipas kategorive, dhe përfshirjen e tyre në buxhet:

| Lloji i prioritetit    | #  | Prioriteti i qytetarëve  | Lokacioni dhe data e dëgjimit publik     | Përfshirë në buxhetin për 2020 | Vlera e buxhetuar | Përfshirë në KAB 2021 | Përfshirë në KAB 2022 |
|------------------------|----|--|--|--------------------------------|-------------------|-----------------------|-----------------------|
| INFRASTRUKTURË RRUGORE | 1  | Rregullimi i rrugëve të fshatit të varrezat e Landovicës   | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has           | PO                             | 60.000 €          | JO                    | JO                    |
|                        | 2  | Ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës Dedaj-Gegisht, Lubizhdë   | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has           | PO                             | 130.000 €         | JO                    | JO                    |
|                        | 3  | Asfaltimi i rrugës në Karashingjergj në gjatësi prej 300 m.  | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has           | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                        | 4  | Përfundimi i rrugëve që kanë mbetur në gjysmë punimet  | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has           | PO                             | 100.000 €         | JO                    | JO                    |
|                        | 5  | Investime në infrastrukturë rrugore në fshatin Krajk   | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has           | PO                             | 40.000 €          | JO                    | JO                    |
|                        | 6  | Regullimi i disa rrugicave në fshatin Kobaj  | Shkolla Fillore Dëshmorët e Zhurit, Zhur | PO                             | 50.000 €          | JO                    | JO                    |
|                        | 7  | Rregullimi i rrugicave në lagjen Ahmetaj dhe Zekëve  | Shkolla Dëshmorët e Kabashit, Korishë    | PO                             | 100.000 €         | JO                    | JO                    |
|                        | 8  | Rregullimi i rrugës kryesore dhe disa rrugicave ndërlidhëse në Lubizhdë  | Shkolla Dëshmorët e Kabashit, Korishë    | PO                             | 100.000 €         | JO                    | JO                    |
| UJË DHE KANALIZIM      | 9  | Përfundimi i rrjetit të kanalizimit në Landovicë   | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has           | PO                             | 70.000 €          | JO                    | JO                    |
|                        | 10 | Zgjidhja e problemit të kanalizimit në Lugashtë  | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has           | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                        | 11 | Rehabilitimi i kanalizimit dhe zgjidhja e problemit me ujësjellës në Gjonaj                                    | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has           | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                        | 12 | Rregullimi i kanalizimeve në Kushnin   | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has           | PO                             | 100.000 €         | JO                    | JO                    |
|                        | 13 | Rregullimi i kanalizimit në Korishë  | Shkolla Dëshmorët e Kabashit, Korishë    | PO                             | 150.000 €         | JO                    | JO                    |
|                        | 14 | Beqir ukaj – Korishë – reduktimi i kohës paskoshme të ujit   | Shkolla Dëshmorët e Kabashit, Korishë    | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                        | 15 | Shoqata Qehaja- të hapet rruga e Duhit , jemi 10 shtëpi pa kanalizim , zgjidhje ka por nuk po don kush me punu | Shkolla Dëshmorët e Kabashit, Korishë    | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
| ARSIM                  | 16 | Ndërtimi i një shkolle dhe kopshti për fëmijë në Karashingjergj  | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has           | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                        | 17 | Krijimi i klasave parashkollore në Gjonaj  | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has           | JO                             |                   | JO                    | JO                    |

| Lloji i prioritetit     | #  | Prioriteti i qytetarëve  | Lokacioni dhe data e dëgjimit publik             | Përfshirë në buxhetin për 2020 | Vlera e buxhetuar | Përfshirë në KAB 2021 | Përfshirë në KAB 2022 |
|-------------------------|----|--|--|--------------------------------|-------------------|-----------------------|-----------------------|
| ARSIM                   | 18 | Ndërtimi i shkollës në Shkozë  | Shkolla Fillore Dëshmorët e Zhurit, Zhur         | PO                             | 70.000 €          | JO                    | JO                    |
|                         | 19 | Renovimi i shkollës Dëshmorët e Zhurit   | Shkolla Fillore Dëshmorët e Zhurit, Zhur         | PO                             | 176.650 €         | PO                    | PO                    |
|                         | 20 | Ndërtimi i sallës së sporteve, izolimi i mureve të shkollës dhe vendosja e ndriçimit në shkollën Dëshmorët e Kabashit, Korishë | Shkolla Dëshmorët e Kabashit –Korishë 22.08.2019 | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                         | 21 | Zhurr-Zgjidhja e problemit të shtëpisë së kulturës   | Shkolla Fillore Dëshmorët e Zhurit, Zhur         | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                         | 22 | Rehabilitimi i shkollës në fshatin Caparc, dhe rehabilitimi i rrugëve përskaaj saj   | Shtëpia e Bardhë, Prizren                        | PO                             | 100.000 €         | JO                    | JO                    |
| KULTURË, RINI DHE SPORT | 23 | Ndërtimi i një terreni sportiv në fshatin Gjonaj   | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has                   | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                         | 24 | Ndërtimi i një muzeu në Lugishtë   | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has                   | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                         | 25 | Ndërtimi i infrastrukturës sportive për klubin e futbollit Vllazëria   | Shkolla Fillore Dëshmorët e Zhurit, Zhur         | PO                             | 150.000 €         | PO                    | PO                    |
|                         | 26 | Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në Manastirc   | Shkolla Meto Bajraktari, Reqan                   | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                         | 27 | Rregullimi i fushës, ndriçimit dhe shtigjet e stërvitjeve në stadiumin e Prizrenit   | Shtëpia e Bardhë, Prizren                        | PO                             | 185.000 €         | PO                    | PO                    |
|                         | 28 | Renovimi i shtëpisë së kulturës, ngrohja në qendrën sportive, renovimi i qendrës rinore dhe subvencione për klubet sportive    | Shtëpia e Bardhë, Prizren                        | PO                             | 150.000 €         | PO                    | PO                    |
|                         | 29 | Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën Jeta e Re   | Shtëpia e Bardhë, Prizren                        | PO                             | 120.000 €         | JO                    | JO                    |
|                         | 30 | Rehabilitimi i qendrës kulturore turke   | Shtëpia e Bardhë, Prizren                        | PO                             | 80.000 €          | JO                    | JO                    |
|                         | 31 | Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në Reqan   | Shkolla Meto Bajraktari, Reqan                   | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                         | 32 | Rehabilitimi i zonave të prekura nga vërshimet në lagjen Kukaj, Korishë  | Shkolla Dëshmorët e Kabashit, Korishë            | PO                             | 50.000 €          | JO                    | JO                    |
|                         | 33 | Ndërtimi i një salle të sportit në Lubinje të Poshtme  | Shkolla Meto Bajraktari, Reqan                   | JO                             |                   | JO                    | JO                    |

| Lloji i prioritetit | #  | Prioriteti i qytetarëve  | Lokacioni dhe data e dëgjimit publik     | Përfshirë në buxhetin për 2020 | Vlera e buxhetuar | Përfshirë në KAB 2021 | Përfshirë në KAB 2022 |
|---------------------|----|--|--|--------------------------------|-------------------|-----------------------|-----------------------|
| ARKEOLOGJI          | 34 | Të instalohet një menaxhim i guidave, dhe mbrojtja dhe përkujdesja e pasurive arkeologjike   | Shtëpia e Bardhë, Prizren                | PO                             | 40.000 €          | PO                    | PO                    |
| MIRËQENIE SOCIALE   | 35 | Ndërtimi i shtigjeve për biçikleta dhe ndalja e ndërtimeve pa leje, Korishë  | Shkolla Dëshmorët e Kabashit, Korishë    | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                     | 36 | Rehabilitimi i banesave kolektive në lagjen Lakuriq  | Shtëpia e Bardhë, Prizren                | PO                             | 130.000 €         | PO                    | PO                    |
|                     | 37 | Të investohet në zbatimin e strategjisë për integrim të komuniteteve RAE   | Shtëpia e Bardhë, Prizren                | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
| SIGURI              | 38 | Rregullimi i ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e rrugëve në Lugishtë  | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has           | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                     | 39 | Të vendosen kamerat e sigurisë dhe të bëhet rregullimi i infrastrukturës dhe ndriçimi publik në mënyrë që të ketë siguri sidomos për fëmijët | Shtëpia e Bardhë, Prizren                | PO                             | 20.000 €          | PO                    | PO                    |
|                     | 40 | Vendosja e ndriçimit publik në Karashigjergj   | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has           | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                     | 41 | Vendosja e ndriçimit publik në Shkozë  | Shkolla Fillore Dëshmorët e Zhurit, Zhur | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
|                     | 42 | Adresimi i problemit me deponinë e mbeturinave në Landovicë  | Shtëpia e Kulturës Gjonaj, Has           | PO                             | 400.000 €         | PO                    | PO                    |
| MJEDIS              | 42 | Rregullimi i shtratit të lumit në Reqan  | Shkolla Meto Bajraktari, Reqan           | JO                             |                   | JO                    | JO                    |
| AGRIKULTURË         | 44 | Ndërtimi i një tregu për bylmet në Reqan   | Shkolla Meto Bajraktari, Reqan           | JO                             |                   | JO                    | JO                    |